

ZJARRI

RIVISTA DI CULTURA ALBANESE - anno XVII - n. 29

PERMBAJTJA - sommario

MAHIR DOMI

- 5 *Mbi zhvillimin e gjuhës letrare shqipe*

FRANCESCO ALTIMARI

- 18 *La parlata di Macchia Albanese: appunti fonologici*

LEONARDO M. SAVOIA

- 43 *Aspetti morfologici delle parlate arbëreshe*
La morfologizzazione del vocalismo tematico nel perfetto in *o in alcune parlate arbëreshe

LUCA FERRONE (a cura di)

- 65 *Testi orali della comunità arbëreshe di Palagorio*

GIUSEPPE SICILIANO (a cura di)

- 70 *Testi e canti popolari della comunità arbëreshe di Cerzeto - I*

GEORGE D. GALLARO

- 77 *Le comunità bizantino-greche dell'Italia meridionale nel secolo IX*

-
- 87 *Letteratura*

-
- 90 *Recensioni e segnalazioni bibliografiche*

-
- 108 *Osservatorio*

ZJARRI - il fuoco rivista di cultura albanese

Anno XVII - 1985 - N. 1-2

Fascicolo N. 29

Direttore:
Giuseppe Faraco

Redazione:
Francesco Solano, Francesco Altimari

Hanno collaborato in questo numero:

Martin Camaj, Mahir Domi, Franca Faraco, George D. Gallaro, Leonardo M. Savoia, Giuseppe Siciliano, Pasquale De Marco.

Direzione e Amministrazione:
Vico I Roma
87069 S. Demetrio C. - I
☎ (0984) 956084
☎ (0983) 84062

Autorizz. Trib. di Rossano
N. 33 del 29-1-1970

C.C.P. n. 11100872 intestato a "Zjarri" - rivista di cultura albanese - 87069 S. Demetrio Corone.

I manoscritti inviati alla Direzione non si restituiscono anche se non pubblicati.

Copertina di:
Damiano Minichi

Stab. Tip. Edit. Biondi C.
Via P. Giglio ☎ 38880
87100 Cosenza

MBI ZHVILLIMIN E GJUHËS LETRARE SHQIPE

1. Letërsia në gjuhë shqipe, dhe, me të, gjuha e shkruar shqipe, nis relativisht vonë, në shekullin XVI, po jo më vonë se edhe disa gjuhë të tjera sot mjaft të zhvilluara, si rumanishtja, lituanishtja etj. Libri i parë shqip i botuar që na ka arritur "Meshari" i Gjon Buzukut, është i vitit 1555. Po shqipja është shkruar edhe më parë, siç na e tregojnë disa shkrime të vogla të mëparshme, dëshmi të ndryshme dhe gjuha e përpunuar, herë-herë relativisht e zhdërvjelltë, e veprës së parë të botuar që njohim.

Shqipes, për shkak të kushteve e të rrethanave historike, iu desh të çajë me zor rrugën e saj si gjuhë e shkruar, të ndeshet me pengesa të ndryshme. Në kohën e lashtë stërgjyshërit e shqiptarëve u ndodhën në kontakt të afërt me kulturën aq të lulëzuar greke. Më pas, shqiptarët për shekuj e shekuj u përfshinë në formacione shtetërore që kishin si gjuhë zyrtare gjuhë me rreze përdorimi shumë të gjera. Shqipja që e shtrënguar të luftojë për t'u afirmuar si gjuhë e shkruar, duke u ndeshur me prestigjin që gëzonin si gjuhë kulture e fetare universale gjuhë si latinishtja, greqishtja e, gjatë pushtimit turk, edhe arabishtja.

Në shekujt XVI-XVIII u krijua e u zhvillua një letërsi fetare e didaktike shqipe. Autorët e saj bënë përpjekje për formimin e zhvillimin e një gjuhe të shkruar relativisht të përpunuar e për pasurimin e saj, aq sa e lejonte tematika e kufizuar e shkrimeve të tyre. Në sajë të kësaj veprimtarie u formua një farë koineje letrare veriore, që vijoi edhe më pas. Krahas kësaj tradite letrare në shekullin XVIII u formuan edhe tradita të tjera letrare, po pa kujdesin për gjuhën që është shfaqur në letërsinë e vjetër veriore, pa i dhënë zhvillimin e duhur gjuhës së shkruar. Që nga fundi i shekullit XVI u krijua tradita letrare arbëreshe, edhe ajo së pari me libra e poezi fetare, të shkruara në variantin arbëresh të gjuhës shqipe.

Me gjithë rrethanat e vështira, mungesës së lidhjeve të rregullta

midis Shqipërisë edhe kolonive arbëreshe të Italisë, nuk munguan kontakte të herëpashershme midis autorëve të Shqipërisë dhe autorëve arbëreshë. Gjurmimi i imtë i këtyre kontakteve e lidhjeve do të nxirte në dritë shumë fakte pak të njohura, me interes të veçantë për historinë kulturore të kombit shqiptar. Ka të dhëna se studiues arbëreshë kanë njohur veprat e disa autorëve tanë të vjetër, letrarë arbëreshë kanë integruar në të folmen arbëreshe të shkrimeve të tyre edhe fjalë të shqipes veriore të nxjerra prej këtyre autorëve.

Mund të themi se gjuha letrare shqipe gjer në shekullin XIX, me gjithë një tog rezultatesh të arritura, për shkak të kushteve historike të kohës, nuk mundi të ketë një shtjellim të rregullt: ajo u shkrua në dy dialektet e gjuhës shqipe, shpesh në format e nëndialekteve të saj, dhe pati një zhvillim jo të vijueshëm, as të gjerë, por të kufizuar e në një masë të madhe të copëzuar, pa arritur të krijojë një traditë të shkruar të përcaktuar mirë të përbashkët, të njëjtë.

Gjendja ndryshoi në shekullin XIX, kur u krye një kthesë e madhe edhe në fushën e gjuhës letrare, në lidhje të ngushtë me ndryshimet e mëdha ekonomike, shoqërore, kulturore, ideologjike që u shënuan në jetën e popullit shqiptar, me hovin që mori letërsia shqipe, me lëvizjen e organizuar të zgjimit dhe të çlirimit kombëtar, që u bë gjithnjë e më e fuqishme. Është periudha e formimit të kombit shqiptar, periudha e Rilindjes sonë kombëtare, një nga periudhat e ndritura të historisë sonë. Ajo i dha një zhvillim të gjithanshëm edhe gjuhës letrare, e ngriti atë në shkallën e një gjuhe letrare të përpunuar, të një gjuhë letrare kombëtare, hodhi themelet e gjuhës së sotme letrare shqipe.

Rilindasit u dhanë rëndësi problemeve gjuhësore, duke i lidhur ato me veprimtarinë e gjerë që duhej shtjelluar në fushën kulturore për zhvillimin e mëtejshëm të vetëdijes kombëtare e të ideve të çlirimit kombëtar. Në kuadrin e çështjeve kulturore të para në një frymë iluministe e patriotike, gjuha kishte një vend të veçantë. Njerëzit e ndritur të Rilindjes, në kushtet e përçarjes feudale dhe të prapambetjes në të cilën dergjej populli ynë, e shihnin gjuhën si një karakteristikë kryesore të kombit shqiptar, hallkë të rëndësishme të njësisë e të bashkimit të tij, mjet mbrojtjeje kundër përpjekjeve shkombëtarizuese, njëhnin rolin e saj si shprehje e mjet i rëndësishëm i kulturës kombëtare. Zhvillimi i arsimit në gjuhën amtare dhe përparimi kulturor e shoqëror i popullit shqiptar kërkonin përpunimin e përsosjen e mëtej-

shme të gjuhës së shkruar shqipe për ta bërë të aftë t'u përgjigjej detyrave të reja historike, për ta ngritur atë në një shkallë më të lartë.

Në Rilindjen u ndërnuar një punë në përmasa të gjëra për të zgjidhur çështje të ndryshme, teorike dhe praktike, për ta pastruar e përsosur gjuhën letrare. Zhvillimi i shpejtë i letërsisë artistike, i llojeve të ndryshme të saj, i publicistikës, i letërsisë shkencore e mësimore, e ngriti gjuhën letrare në një nivel pa krahasim më të lartë se ai i mëparmi.

Rilindasit, ndryshe nga ç'ndodhi në disa vende të tjera, vunë në bazë të gjuhës letrare gjuhën e gjallë të kohës, gjuhën popullore, dhe iu vunë punës për ta përpunuar më tej atë, për ta bërë një gjuhë të zhvilluar kulture.

U shtjellua një punë jo e paktë për kodifikimin e gjuhës letrare. Pasi pikënisje e parë ishte gjuha e folur, duheshin mënjanuar veçoritë lokale, duheshin seleksionuar fjalët, trajtat e shprehjet, duheshin pakësuar luhatjet, duhej stabilizuar drejtshkrimi. Nëpërmjet një procesi gradual u arrit të formohej një gjuhë letrare e kodifikuar në një masë të mirë, në dy variante, nga të cilët njëri, varianti jugor, ishte më i njësuar dhe më i stabilizuar. Ky i fundit me zhvillimin e mëtejshëm do të bëhej varianti kryesor i shqipes letrare kombëtare të njëjtë. I pari u shkrua në formën e dy nënvarianteve, të nënvariantit verior e të nënvariantit qendror të tij.

Rilindasit shtruan edhe problemin e njësimimit të plotë të gjuhës letrare shqipe. Që në periudhën e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit këtë e shtronte me qartësi dhe me optimizmin karakteristik të tij ideologu e udhëheqësi i shquar i Rilindjes, dijetari Sami Frashëri. Në letrën që i dërgon nga Konstandinopoja De Radës më 2.II.1881 shkruan ndër të tjera: « Pun' e të gjallurit të gjuhësë shqip edhe të bashkuarit të dialekteve t'asaj e të ndritësuarit të kombit tënë, që është një punë shumë e vjejturë e e shejtëruarë, është pun' e shoqërisë sonë ». Daljen nga faza e varianteve të mbështetura në koinetë dialektore ai e përcaktonte si një detyrë për t'u zgjidhur në një të ardhme të afërt, jo në një perspektivë të largët. Lidhur me nevojën e daljes së një fletoreje në gjuhën shqipe në Shqipëri, ai shpreh bindjen e realizimit të shpejtë të saj « në gjuhëtë shqip të pandame e të njëjtë, sikundër duhet të jetë edhe Shqipëria, se shumë gjuhë e dialekte sjellin, në ndarje e mërgim (nënvizimet janë tonat M. D.). Vërtet ne kemi disa dialekte,

po këto nuk janë të huaja njëra nga tjetra; po ca nga fraset' edhe nga fjalëtë e gjuhësë janë humburë më ca anë të Shqipërisë e të kolonivet e janë rojturë në ca anë të tjera; shumë fjalë, frase e mbujtime të fjeshta e të mira që rojnë në Shqipëri, janë humburë nëpër kolonitë; shumë të tjera janë humburë në Shqipëri e rojnë nëpër kolonitë; kështu edhe në mest të Gegërisë e të Toskërisë e të ngastrave të sejcilës. Me të mbledhurë të gjithë këtyre fjalëve e frasëve bashkë, edhe gjuha shqip do të bënetë e begatë, e gjerë, e do të shpëtonjë nga të pasurit nevojë më fjalë të huaja, edhe gjithë dialektet do të gjendenë të bashkuara e të përziera ».

Ideja e ndërveprimit dialektor në formimin e gjuhës letrare të njësuar ishte gjerësisht e përhapur në Rilindje, sidomos në dekadat e para të saj. Po për mënyrat e realizimit të saj kishte mendime të ndryshme. Mjaft përfaqësues të Rilindjes mendonin se ky ndërveprim duhej realizuar jo vetëm me zgjedhjen e fjalëve më të përshtatshme, të cilësdo të folme që të ishin ato, por edhe me përzjerjen e kombinimin edhe të trajtave fonetike e morfologjike.

Mendjet më të ndritura të Rilindjes patën gjithnjë dëshirë të afrojnë vazhdimisht dy variantet letrare, me synimin e një gjuhe letrare të njësishtme. Lëvruesi i shquar i gjuhës letrare shqipe të shek. XIX, filologu K. Kristoforidhi, në shqipërimin e botimin e librave kish-tarë në dy variante, pati një kujdes të veçantë për këtë, dhe bëri një punë të madhe, të mbështetur në një njohje të gjerë të pasurive të gjuhës sonë.

Si hap paraprak i njësimin të letrare ishte zgjidhja e problemit të alfabetit të shqipes.

Alfabeti me shkronja të veçanta, as latine, as greke, që përpiloi e përdori në abetarët e tij (1844-1845) përfaqësuesi i parë i shquar i Rilindjes sonë kombëtare Naum Veqilharxhi, – i pari alfabet i hartuar në një platformë të përgjithshme kombëtare dhe me përpjekje të vetë-dijshme për të dhënë në mënyrën sa më të plotë e të saktë sistemin e tingujve të shqipes – për arsye të ndryshme nuk arriti të ketë përhapje të gjerë, aq më pak të përgjithësohet. Alfabeti i caktuar më 1879 nga « Shoqëria e shkronjzave » e Konstantinopojës, kryesuar nga S. Frashëri, i bazuar në alfabetin latin, me disa shkronja greke e me disa shkronja të modifikuara, zotëroi për mjaft dekada, por me kohë krahas tij u përdorën edhe alfabetë të tjera me lloj lloj variantesh. Gjendja e pakënaqshme që u krijua u kapërcye me vendimet e Kongre-

sit kombëtar të Manastirit në nëntor 1906, kur u caktua si alfabet i njësuar i shqipes alfabeti që përdorim edhe ne sot (').

Krahas letërsisë shqipe të zhvilluar në Shqipëri dhe në qendrat e jashtme ku jetonin dhe vepronin koloni shqiptare, si në Bukuresht, Konstandinopojë, Egjipt, Bullgari etj., duke i paraprirë për një kohë edhe asaj, u zhvillua edhe një letërsi e pasur arbëreshe, me vlera të shquara artistike dhe patriotike, gjatë gjithë shekullit XIX dhe dekadës së parë të shekullit XX. Prodhimi i gjerë dhe i larmishëm i saj, sidomos në poezi e publicistikë, i përfaqësuar me veprat e një sërë letrarësh me vlerë si A. Santori, Z. Serembe, G. Dara e të tjerë, në krye të të cilëve qëndron figura e madhe e J. De Radës, dha dorë që edhe varianti arbëresh i gjuhës letrare shqipe të pasurohet, të shkathësohet, duke fituar mundësi shprehëse të reja. Nëpërmjet kontakteve më të dendura me veprat e Rilindjes shqiptare, autorët arbëreshë të shek. 19 përdorën edhe trajta e sidomos fjalë të gjuhës letrare të Shqipërisë, ndërsa, anasjelltazi, në këtë gjuhë letrare filluan të hyjnë edhe fjalë të arbëreshëve të Italisë, duke u realizuar një proces ndërkomunikimi, gjithnjë e më efektiv, me dobi për pasurimin dhe njësimin e vijueshëm të gjuhës letrare shqipe, proces që vijoi edhe në periudhën e mëpasme.

Për t'iu përgjigjur kërkesave të epokës së re të Rilindjes, për t'u ngritur në shkallën e një gjuhe letrare mjaftësisht të zhvilluar, gjuha shqipe duhej edhe pasuruar, kryesisht me fjalë të sferave të kulturës, që të shprehnin nocionet e ndryshme abstrakte, edhe me termat e degëve të ndryshme të shkencës e të kulturës. Njëkohësisht duhej pastruar ajo nga fjalët e huaja të panevojshme, që ishin në përdorim në gjuhën e folur të përditshme, sidomos në disa zona, fjalë që dëmtonin fizionominë e veçantë dhe origjinalitetin e gjuhës shqipe.

Rilindasit u bënë një luftë të madhe fjalëve të huaja, dhe u treguan përgjithësisht puristë të vendosur, veçanërisht në fazat e para të Rilindjes, si në përpjekjet për zëvendësimin e fjalëve të huaja të gjuhës bisedore, si në pasurimin e mëtejshëm të shqipes. Ata u shpallën luftë në radhë të parë fjalëve turke e fjalëve orientale të depërtuara nëpërmjet turqishtes, po ashtu edhe fjalëve greke të hyra nëpërmjet kishës dhe shkollës në gjuhë greke, e disa shtresave të tjera fjalësh të huaja duke u lidhur kjo veprimtari me luftën e gjithanshme kundër robërisë turke dhe kundër politikës shkombëtarizuese të rretheve shoviniste të disa vendeve fqinje. E njëjta gjë kishte ndodhur më parë a

ndodhte po në atë kohë në disa vende të tjera të Ballkanit, sidomos në Bullgari, Rumani, ku, gjatë shekullit XIX, u mënjanuan nga gjuha letrare një masë e madhe turqizmesh e greqizmesh.

Rilindasit zhvilluan një veprimtari të gjerë e përgjithësisht të frytshme për zgjerimin e pastrimin e fondit leksikor të gjuhës letrare. U krijuan shumë fjalë të reja me mjetet fjalëformuese të gjuhës sonë, sipas modeleve të saj ose me përkthime, sipas modeleve të gjuhëve të tjera. Rilindasit shqipëruan edhe fjalë e terma të karakterit ndër-kombëtar, nga të cilat zunë vend vetëm një pjesë. Ja disa prej tyre: *dritëshkronjë* për fotografi, *dhemasje* për "gjeometri", *dhetregonjë* = gjellogji, *dheshkronjë* = gjeografi, *gjallëtreronjë* = biologji, *gjithëurdhëronjë* = republikë, *gjithëmësime* = universitet, *gjelbërore* = oaz, *kafshëshkronjë* = zoologji, *mësonjëto* = shkollë, *numëratore* = aritmetikë, *njeritregonjë* = antropologji, *njëurdhëronjë* = mbretëri, monarki, *pakryesi* = anarki, *qielltreronjë* = astronomi, *shtypshkronjë* = tipografi, *tejshkronjë* = telegraf, *veturdhuronjë* = autokraci, absolutizëm, *rrotullohës* = satelit etj.

Krahas formimit të fjalëve të reja, për pasurimin e pastrimin e leksikut u vunë në përdorim edhe mënyra të tjera, u ndoqën edhe rrugë të tjera. U zgjeruan kuptimet e disa fjalëve të gjuhës popullore, duke u dhënë atyre herë-herë edhe kuptime abstrakte (p. sh. *boshti* i tokës = axe, *brez* = zonë, *drudhe* = molekulë, *kënd* = angle, *pellgore* = arqipelag etj.), u shtinë në përdorim fjalë dialektore që meritonin të përgjithësoheshin në gjuhën letrare, rrallë edhe ndonjë arkai-zëm, për të zëvendësuar fjalë të huaja ose për të dhënë nuanca kuptimore a stilistike.

Në një interval kohe relativisht të shkurtër prej pak më shumë se një gjysëm shekulli, gjuha letrare shqipe kish bërë një hop cilësor të shënuar. Ajo po mirrte tiparet e një gjuhe letrare kombëtare, me një leksik mjaftësisht të zhvilluar, me një gramatikë dhe drejtshkrim në një masë të madhe të kodifikuar, po me dy variante, që shkonin duke u afuar, po pa arritur në formimin e një gjuhe letrare të njësuar e plotësisht të kristalizuar në të gjitha rrafshet e hallkat e saj (*).

Pas 28 nëntorit 1912, që kurorëzoi përpjekjet shekullore të popullit shqiptar për liri e pavarësi me krijimin e shtetit shqiptar, për gjuhën letrare shqipe u krijuan kushte e detyra të reja. Ajo ishte tani edhe gjuhë e shtetit shqiptar, e institucioneve dhe e akteve të tij, gjuhë e përgjithshme e shkollës. Kjo kërkonte që shqipja letrare të shkonte

më tej, me një ritëm edhe më të shpejtë, në rrugën e zhvillimit, të pasurimit, përpunimit dhe kodifikimit të saj, dhe krijoi, për realizimin e këtyre detyrave, edhe mundësi të reja.

Për hir të dëshirave të zjarra të popullit shqiptar për arsim e kulturë e të përpjekjeve të forcave përparimtare, me gjithë kushtet e rënda të regjimeve feudaloborgjeze, u arritën rezultate në ngritjen arsimore-kulturore, mori zhvillim më të gjerë letërsia. Si pasojë, shkoi përpara gjuha letrare, u ngrit ajo në një nivel më të lartë, në një shkallë më të përpunuar. Përfundimet mund të kishin qenë edhe më të mëdha, ritmi i zhvillimit edhe më i shpejtë, po të ishte treguar kujdesi i nevojshëm nga organet qeveritare e të ishin krijuar mundësitë për të shtjelluar një punë të gjerë, të menduar mirë, të mbështetur prej një institucioni shkencor. Çka u realizua u detyrohet kryesisht përpjekjeve të mjaft lëvruesve patriotë të gjuhës, veprimtarisë së masës së madhe të arsimtarëve, të punës së mjaft shkrimtarëve dhe luftës së forcave përparimtare të vendit. Elementët reaksionarë u përpoqën ta pengojnë procesin e zhvillimit konvergjent të varianteve letrare drejt një afrimi më të madh të tyre, për të cilin afrim kishin luftuar rilindasit e shquar; në raste të ndryshme dolën haptazi ose tërthorazi kundra gjuhës letrare kombëtare, me qëndrime lokaliste, partikularistë. Përpjekjet e tyre ngadalësuan, por nuk mundën ta ndalnin zhvillimin e gjuhës letrare shqipe në drejtim të njësimi e të kodifikimit të mëtejshëm të saj.

2. Çlirimi i vendit tonë nga pushtuesit fashisto-nazistë dhe bashkëpunëtorët e tyre (29 Nëntor 1944), ngritja e Pushtetit Popullor e gjetën gjuhën letrare të panjësuar, të pakristalizuar plotësisht në tërë hallkat e saj, qoftë edhe në dy variantet në të cilat shkruhej. Varianti letrar jugor ishte shkathtësuar edhe më shumë, e kishte shtrirë edhe më tej rrezën e veprimit të tij. Ndër dy bashkëvariantet veriore, kishte ecur përpara nënvarianti i mesëm, ai ishte afruar më shumë me variantin jugor, ishte kodifikuar më tej, ishte shtuar shkalla e përdorimit të tij.

Fitorja e Revolucionit Popullor krijoi kushte cilësisht të reja, hapi perspektiva të shkëlqyera edhe për të ecur përpara, në rrugë të drejtë e me ritme të shpejta, procesi i gjuhës letrare – ashtu si e kërkonte jeta e re, në të cilën kishte hyrë populli ynë – për përpunimin, njësimin dhe kristalizimin e saj plotë në të gjitha rrafshet e në të gjitha hallkat e sistemit.

Transformimet e mëdha që u kryen në të gjitha fushat e sektorët, zhvillimi me hapa veçanërisht të shpejtë i arsimit e i kulturës, përparimi i shkencës dhe i teknikës, krijimi i institucioneve kërkimore, roli gjithnjë më i madh i formës së folur të gjuhës letrare me konferencat e fjalimet, me teatrin, televizionin etj., krijuan mundësi shumë të mëdha për zgjerimin dhe përforcimin e veprimit të gjuhës letrare, duke marrë edhe funksione të tjera të reja. Zhdukja e plotë e analfabetizmit, realizimi i arsimit tetëvjeçar të detyrueshëm, shtrirja e gjerë e rrjetës së arsimit të mesëm, ngritja e asimit të lartë, shtimi i madh i botimeve, e bënë kulturën të masave dhe, me këtë, i shtuan, pa krahasim me të kaluarën, radhët e përdoruesve të gjuhës letrare, fuqizuan shumë mundësitë e veprimit të saj. Revolucioni socialist e zgjeroi dhe e forcoi shumë bazën shoqërore të bashkëveprimit. Me intensifikimin e kontakteve midis qyteteve e rretheve, me lëvizjet e ndryshme të popullsisë që ka sjellë industrializimi i vendit, me ndryshimet që kanë ndodhur nga urbanizmi në përbërjen e popullsisë së qendrave të vjetra, dhe me krijimin e qendrave të reja me popullsi prej krahinash të ndryshme, me të gjithë këto iu shkulën rrënjët veçimit krahinor dhe partikularizmeve dialektore, u formuan e u përforcuan premisa gjithnjë e më vepruese e të fuqishme për procesin e njësimiit gjuhësor.

Gjuha letrare, në anë tjetër, u pasurua në drejtime të ndryshme, me ritme shumë të shpejta, u shkathtësua më shumë, fitoi mundësi të reja shprehëse, u kristalizua më tej. U krijuan një terminologji e pasur për degët e ndryshme të shkencës e të teknikës, duke shfrytëzuar mjetet fjalëformuese të shqipes, e në një masë të mirë edhe modelet e saj, pa rënë në një purizëm të paarsyeshëm. Një kujdes i madh i kushtua gjuhës letrare e problemeve të saj nga organet shtetërore e entet shoqërore. Një punë e vijueshme dhe e shumanshme u shtjellua për to nga institucionet e organizmat shkencore.

Për hir të një politike të drejtë, të menduar mirë, të një veprimtarie të gjithanshme, – arsimore, studimore, botuese etj., – shkoj përpara gradualisht, me hapa të sigurtë, procesi i afrimit të varianteve dhe i kodifikimit gjithnjë e më të madh të gjuhës letrare, gjersa u arrit të realizohet detyra e madhe historike e njësimiit të plotë të gjuhës letrare dhe e kristalizimit të saj në të gjitha hallkat. Projekti i drejtshkrimit i botuar më 1967 shënoi kalimin në drejtshkrimin plotësisht të njësuar. Ai iu shtua një diskutimi publik të gjerë për disa vjet dhe gjeti pëlqimin e përgjithshëm. Në nëntor 1972 u mbledh në Tiranë

Kongresi i Drejtshkrimit, në të cilin merrnin pjesë gjuhëtarë, shkrimtarë, arsimtarë e të tjerë nga gjithë anët e Shqipërisë, por edhe nga shqiptarët e Krahinës Autonome Socialiste të Kosovës, të Maqedonisë e të Malit të Zi, si edhe studiues arbëreshë të Italisë. Me miratimin e kritereve dhe të zgjidhjeve të përgjithshme dhënë prej kësaj mbledhje të madhe shkencore drejtshkrimit të njësuar të gjuhës shqipe, u konsakrua përfundimisht njësimi i plotë i gjuhës letrare, gjuha letrare e njëjtë për të gjithë shqiptarët. U përmbush me këtë një aspiratë e popullit shqiptar, një dëshirë e zjarrtë e mendjeve më të ndritura e më të përparuara të Rilindjes sonë kombëtare e të periudhës së mëpastajme. Udhëheqësi ynë shoku Enver Hoxha ka thënë shumë mirë se kjo « është një fitore e pallogaritshme në mes aq fitoreve të tjera të madhërishtme që ak korrur populli ynë me luftë, me përpjekje e me zotësi ».

Njësimi e kristalizimi i gjuhës sonë letrare kombëtare u mbështet në një variant të caktuar letrar por me një bashkëveprim të fuqishëm ndërdialektor në bazë të një vëzhgimi të vëmendshëm të realitetit gjuhësor e të evolucionit të tij, të proceseve të gjalla të zhvilluara në këto dekadat e fundit e të rezultateve të tyre. Themelin e kësaj gjuhe letrare të njësuar e përbënë elementet e përbashkëta të dy dialekteve. Ato patën peshën më të madhe (?). Dialektet e të folmet e gjuhës shqipe janë mjaft të afërta, ndryshimet ndërmjet tyre janë kryesisht fonetike dhe jo të thella. Me tiparet kryesore fonetike mbizotëruese të dialektit jugor, – që i ka ruajtur më të plota trajtat e fjalëve, pa rëniet e reduktimet e shumta të të folmeve veriore, shekujt e fundit ai ka pësuar më pak ndryshimet (tipare si rotacizmi i n ndërzanore, ruajtja e diftongjeve ose dyzanoreve -ie, -ye, -ua, po ashtu ruajtja përgjithësisht e ë-së së theksuar në vend të a-së hundore), janë kombinuar dukuri e veçori jo të pakta të dialektit verior, si janë: ruajtja e bashkëtingëllores së fortë rrotullues rr, mosshurdimi i bashkëtingëlloreve të zëshme b, d, dh, g, gj, v, x, xh, z, zh fundore ose përpara bashkëtingëlloreve të shurdheta. Bashkëveprimi ka qenë edhe më i madh në morfologji. Leksiku është pasuruar me mjaft fjalë popullore me prejardhje nga të folmet e ndryshme.

3. Vitet që kanë kaluar nga Kongresi i Drejtshkrimit të gjuhës shqipe, kanë qenë vite të një veprimtarie të shumanshme, të gjerë, për plotësimin e detyrave që u shtrohen edhe të vendimeve që u muarën prej tij për kodifikimin e plotë të gjuhës letrare e për përgji-

thësimin e normave të saj, e njëkohësisht vite realizimesh e përparimesh të kësaj gjuhe të njësuar. U hartuan e u botuan një serë veprash që ndihmuan për përgjithësimin e përsosjen e gjuhës letrare, për ngritjen e kulturës gjuhësore të masave të gjera. Gjuha shqipe, mësimi e studimi i saj u pajisën me të gjitha mjetet e nevojshme të punës. Ndër to mund të përmenden udhëzuesi përfundimtar « Drejtshkrimi i gjuhës shqipe », « Fjalori drejtshkrimor i gjuhës shqipe », « Shenjat e pikësimit », « Fonetika dhe gramatika e gjuhës së sotme shqipe », « Gjuha letrare shqipe për të gjithë », « Fjalori i gjuhës së sotme shqipe » (*). Gjuha letrare gjeti zbatim të plotë në të gjitha botimet, edhe në letërsinë artistike. Ajo depërtoi gjithnjë e më thellë edhe në formën e folur të gjuhës letrare në skenë, në radiotelevizion etj.

Përvetësimi i gjuhës letrare kombëtare dhe zbatimimi i normave të saj shkoi shpejt përpara edhe ndër shqiptarët jashtë Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë. Që në vitin 1968, një konsultë e gjerë e shqiptarëve të Krahinës Autonome Socialiste të Kosovës, të Republikave Socialiste të Maqedonisë e të Malit të Zi dhe të vendeve të tjera të Jugosllavisë u shqiptua për gjuhën letrare kombëtare shqipe të njëjtë në bazë të parimit « një komb një gjuhë letrare ». Nisi të përdoret gjithnjë e më gjerë në veprimtaritë e ndryshme, – arsimore, kulturore, shkencore, botuese, administrative, shoqërore, – gjuha letrare e njësuar. Procesi me kohë u intensifikua shumë dhe u bë i përgjithshëm, duke aritur rezultate të rëndësishme brenda një periudhe të shkurtër. Për hir të rëndësisë që iu dha, të punës që u bë, u kapërcyen të gjitha pengesat që mund të ekzistonin, dhe gjuha letrare kombëtare shqipe u përgjithësua në gjithë shqiptarët e Jugosllavisë. Në simpoziumin shkencor të organizuar në dhjetor 1980 nga Instituti Albanologjik i Prishtinës për « Probleme aktuale të kulturës së gjuhës shqipe », bashkë me bilancin e rezultateve të arritura, u shtruan problemet që dalin për zbatimin e plotë të normave të gjuhës letrare e për ngritjen e mëtejme të kulturës gjuhësore të shqiptarëve të Jugosllavisë, edhe masat që duhen marrë.

Gjuha letrare kombëtare shqipe e njësuar po bëhet gjithnjë e më shumë gjuha e shkruar e gjithë shqiptarëve, kudo që të jetojnë, si e diasporës së vjetër shqiptare ashtu edhe e kolonive dhe e bashkësive shqiptare të vendeve të ndryshme të botës. Rezultate të rëndësishme janë arritur në përvetësimin dhe përdorimin e saj edhe ndër arbëreshët e Italisë. Nevoja e kalimit nga varianti arbëresh në gjuhën

letrare të njësuar po ndihet gjithnjë e më shumë e realizimi i tij po shkon gjithnjë përpara. Përgjithësimi i tij mund të hasë edhe në ndonjë vështirësi. Po s'ka asnjë arsye teorike ose praktike që ta kundërshtojë këtë nevojë të domosdoshme të zhvillimit të kulturës arbëreshe ose të përbëjë një pengesë të pakapërcyeshme. Gjuha letrare është forma më e lartë, e përpunuar, e gjuhës së një populli, ajo s'ka si të përputhet plotësisht e në të gjitha me gjuhën e folur të përditshme, me gjuhën bisedore, aq më pak me të folmen dialektore. Ajo është e kodifikuar, shumë më e pasur, më e zhvilluar, me mundësira shumë më të mëdha shprehëse, mjet i fuqishëm i kulturës së një populli. Nga fakti se midis njërive dialektore të shqipes s'ka ndryshime të shumta e të mëdha, përgjithësimi i normave të gjuhës letrare kombëtare, përvetësimi i saj prej të gjithëve, s'ka përbërë problem, është kryer e po zhvillohet me sukses. Dhe kjo është konstatuar edhe në treva ku e folmja dialektore ka veçori më të theksuara, që e largojnë më shumë nga gjuha letrare kombëtare, siç është rasti i disa të folmeve veriore e verilindore. Rezultatet e shkëlqyera të arritura brenda një hoke të shkurtër në përgjithësimin e gjuhës letrare të njësuar te shqiptarët e Jugosllavisë, janë një provë e pakundërshtueshme e mundësisë së përvetësimit e të përdorimit të gjuhës letrare të njësuar prej gjithë atyre që flasin shqip. Këto mundësi janë edhe më të mëdha për të folme si arbërishtja, që, nga ana fonetike e gramatikore, qëndrojnë shumë afër ose janë identike me bazën kryesore gjuhës letrare kombëtare. Sigurisht ky përgjithësim i gjuhës letrare kombëtare nuk arrihet kudo me të njëjten lehtësi, menjëherë e vetvetiu, pa përpjekje e punë. Po s'ka asnjë pengesë të pakapërcyeshme. Ai mund të kërkojë të zgjidhen paraprakisht një sërë çështjesh kryesisht pedagogjike e didaktike dhe të mirren masa për t'i ndihmuar zhvillimit të procesit gjuhësor-kulturor përkatës.

4. Kështu gjuha letrare shqipe, nëpërmjet një rruge të gjatë, të ndërlikuar, me pengesa, e të një veprimtarie të vijueshme arsimore, kulturore, letrare, studimore, ka arritur sot në shkallën e një gjuhe të pasur, të përpunuar, të njësuar e të kristalizuar në të gjitha nivelet, hallkat e format e saj, të aftë për t'u përgjegjur kërkesave të një shoqërie ndër më të përparuarat.

Por gjuha zhvillohet e përsoset vijimisht, zhvillimi i shoqërisë i nxjerr asaj probleme e detyra të reja. Lufta për përsosjen e vijueshme të gjuhës letrare mbetet si një luftë e përhershme në etapat e ndryshme të jetës së saj.

Gjuha letrare shipe duhet tani të përforcojë, të thellojë arritjet e mëdha të saj, të mënjanojë dobësitë e praktikës së përditshme gjuhësore, të pasurohet më tej, të shtojë mundësitë e saj shprehëse nga të gjitha anët, t'iu përgjigjet ajo zhvillimit të shpejtë të shoqërisë sonë socialiste, kërkasave të sotme gjithnjë e më të mëdha të saj, por edhe nevojave të perspektivës (*).

Një vend të parë zënë tani problemet e kulturës së gjuhës, përpjekjet për ta ngritur edhe më lart nivelin gjuhësor të përgjithshëm të popullit tonë, në lidhje të ngushtë me ngritjen e nivelit kulturor. Në vendin tonë luftohet me sukses për përgjithësimin e plotë të normave të gjuhës letrare e për ngulitjen e tyre në të gjitha hallkat e sistemit gjuhësor, - drejtshkrim, drejtshqiptim, gramatikë, leksik -, në luftë me dukuritë dialektore, me gabimet, me pakujdesinë e qëndrimet pa përgjegjësi ndaj një mjeti kaq të rëndësishëm të jetës shoqërore, të kulturës sonë kombëtare, siç është gjuha, në radhë të parë gjuha letrare. Zhvillohet një veprimtari e gjerë për pasurimin e gjuhës letrare me fjalë e terma të reja, kryesisht nga vetë brumi i saj, dhe për pastrimin e kësaj gjuhe nga fjalët e huaja të panevojshme, për mënjanimin e ndikimit të dëmshëm të gjuhëve të huaja me konstrukte sintaksore që vijnë në kundërshtim më veçoritë e gjuhës shqipe dhe dëmtojnë origjinalitetin e saj.

Problemet e kulturës së gjuhës, lufta për një përsosje të vijueshme e të gjithanshme të gjuhës letrare janë bërë çështje shoqërore e rëndësishme. Për to kanë dalë vendime qeveritare, ndaj tyre tregohet një kujdes i veçantë. Botimi i një organi të ri nga Akademia e Shkencave me emrin "Gjuha jonë", pasqyrimi i çështjeve gjuhësore në organe të ndryshme të shtypit, veprimtaria e gjerë arsimore, shkencore etj. që shtjellohet, kanë vënë në lëvizje të gjithë ata që kanë të bëjnë me fjalën e shkruar dhe e kanë tërhequr vëmendjen e publikut të gjerë për të tilla probleme. Gjuha letrare shqipe po zhvillohet e përsoset edhe më, me ritme të shpejta, po fiton mundësira të reja shprehëse, që po e ngrenë gjithnjë e më lart dhe po e bëjnë një mjet gjithnjë e më të fuqishëm të kulturës kombëtare shqiptare.

MAHIR DOMI

NOTE

(¹) *Alfabeti i gjuhës shqipe dhe Kongresi i Manastirit (14-22 nëntor 1908)* Universiteti i Tiranës, 1972, veçanërisht: M. Domi: *Alfabeti i gjuhës shqipe dhe Kongresi i Manastirit*, fq. 7-50.

(²) Shih Sh. Demiraj: *Disa shënime rreth lëvrimin të gjuhës shqipe gjatë shekullit XIX*, "Buletini i Universitetit shtet. të Tiranës, Shkencat shoqërore", 1958, 4, f. 120-131; 1959, 1, fq. 49-79.

[Dh. Shuteriqi] *Historia e letërsisë shqipe*. Vëll. II, *Letërsia shqipe e Rilindjes kombëtare*, Universiteti i Tiranës, 1961.

M. Domi: *Problemes de la langue litteraire pendant la Renaissance nationale*, "Studia Albanica", Tiranë, 1975, 2, fq. 77-85.

M. Domi: *Aspects de l'évolution et de la codification de l'albanais littéraire durant la période de la Renaissance nationale*, "Studia Albanica", 1980, 2, fq. 93-98.

(³) Shih A. Kostallari: *Mbi disa veçori strukturore e funksionale të gjuhës letrare shqipe të kohës sonë*, "Studime filologjike", 1970, 2, fq. 8-57.

A. Kostallari: *Rruga e formimit të gjuhës sonë të përbashkët letrare*, "Gturmime albanologjike", Prishtinë, 1969, 2, fq. 7-36.

A. Kostallari: *Gjuha letrare shqipe dhe disa probleme themelore të drejtshkrimin të saj*, Akademia e Shkencave, Tiranë 1973.

(⁴) *Drejtshkrimi i gjuhës shqipe*, Komisioni hartues: A. Kostallari (kryetar), M. Domi, E. Çabej, E. Lafa; Akademia e Shkencave, Tiranë 1973.

Fjalori drejtshkrimor i gjuhës shqipe, Komisioni hartues: A. Kostallari (kryetar), M. Domi, E. Lafa, N. Cikuli; Akademia e Shkencave, Tiranë 1976.

Regullat e pikësimin në gjuhën letrare shqipe. (Projekt) Komisioni hartues: M. Domi, M. Totoni (redaktor përgjegjës), N. Cikuli, S. Floqë; Akademia e Shkencave, Tiranë 1981.

Fonetika dhe gramatika e gjuhës së sotme letrare shqipe. II. Morfologjia, Hartuar nga A. Dhrimo, E. Angoni, E. Hysa, E. Lafa, E. Likaj, F. Agalliu, Sh. Demiraj, Redaktor i vëllimit Sh. Demiraj, kryeredaktor M. Domi, Akademia e Shkencave, Tiranë 1976.

Fonetika dhe gramatika e gjuhës së sotme letrare shqipe III. Sintaksa (2. Sintaksa e periudhës). Hartuar nga Sp. Floqi, M. Domi, S. Mancaku, M. Çeliku, St. Prifti; redaktor M. Domi, Maket i poligrafuar, Akademia e Shkencave, 1976, fq. 246+295.

Gjuha letrare shqipe për të gjithë. Elemente të normës së sotme letrare kombëtare. Komisioni hartues: A. Kostallari (kryetar), E. Lafa, M. Totoni, N. Cikuli, Shtëpia botuese e librit shkollor, Tiranë 1976.

Fjalori i gjuhës së sotme shqipe. Hartuar nën drejtimin e A. Kostallarit (kryetar) me redaktorë J. Thomaj, Xh. Lloshi, M. Samara, nga A. Kostallari, J. Thomaj, M. Samara, J. Kole, P. Daka, P. Haxhillazi, H. Shehu, F. Leka, E. Lafa, K. Sima, Th. Feka, B. Keta, A. Hidi. Akademia e Shkencave, Tiranë 1980.

(⁵) Sh. M. Domi: *Probleme të sotme të gjuhës letrare dhe detyra të kulturës së gjuhës*, "Gjuha jcnë", Tiranë 1981, 1, fq. 26-35.

E. Lafa: *Gjuhësia shqiptare për kulturën e gjuhës*, po aty, 1981, 2 fq. 11-21.

I. Ajeti: *Probleme aktuale të kulturës së gjuhës*, po aty, 1981, 2 fq. 22-32.

LA PARLATA DI MACCHIA ALBANESE:
APPUNTI FONOLOGICI *

0. Oggetto di questo studio dialettologico, che fa parte di un lavoro monografico più ampio ed organico sulla parlata di Macchia Albanese (*), è il sistema fonologico di questa parlata arbëreshe. Esso si basa su dati che ho raccolto personalmente "sul campo" nell'estate del 1982, da parlanti originari della comunità presa in esame, e ulteriormente verificati attraverso altre indagini che ho condotto in questa comunità albanofona nel corso del 1983.

L'accurata scelta degli informatori che hanno fornito il materiale linguistico qui utilizzato — che è stato da me registrato o trascritto dal vivo — ubbidiva oltre che alla necessità di dare una fedele descrizione sincronica della parlata, anche all'obiettivo di individuare, sempre nell'ambito della sincronia, quelle variazioni o trasformazioni linguistiche che rientrano in un più generale processo di cambiamento e comunque anticipatrici di tendenze innovative nel sistema fonologico di questa parlata.

Tale approccio comportava ovviamente una metodologia complessa nell'analisi e nell'interpretazione dei fatti linguistici, una metodologia nella quale la sistemazione suggerita da un'ottica strutturalista sembra integrarsi naturalmente con le procedure d'analisi e le formalizzazioni elaborate nel quadro della fonologia generativa, e con la distribuzione extralinguistica dei dati interpretata dall'approccio sociolinguistico. L'eclettismo metodologico che ne è scaturito, non è stato tanto il frutto di una scelta voluta di mediazione fra le teorie linguistiche delle diverse scuole, quanto il risultato naturale e convergente di un tentativo di approccio "globale" nell'analisi e nella descrizione di alcuni aspetti del sistema fonologico di questa varietà dialettale albanese.

* Relazione presentata al corso di linguistica del X Seminario Internazionale di Lingua, Letteratura e Cultura Albanese, svoltosi a Prishtina (Jugoslavia), presso la Facoltà di Lettere dell'Università del Cossovo, dal 15 al 29 agosto 1984.

CENNI GENERALI SUL SISTEMA FONOLOGICO

Il sistema fonologico della parlata di Macchia non si differenzia sostanzialmente da quello della maggior parte delle parlate albanesi d'Italia, che, com'è noto, presentano le caratteristiche comuni del dialetto albanese meridionale.

Esso conta complessivamente 36 fonemi: /p/, /b/, /t/, /d/, /c/, /f/, /k/, /g/, /ts/, /dz/, /tʃ/, /dʒ/, /f/, /v/, /θ/, /ð/, /s/, /z/, /ʃ/, /ʒ/, /ç/, /j/, /ɣ/, /m/, /n/, /ɲ/, /l/, /k/, /r/, /R/, /a/, /e/, /i/, /u/, /o/, /ə/.

Rispetto all'albanese letterario odierno, questa parlata registra, nell'inventario dei fonemi, le seguenti diversità:

- a) neutralizzazione dell'opposizione arrotondato/non arrotondato nell'ambito delle vocali alte anteriori, dovuta alla scomparsa dal sistema vocalico del fonema /y/, vocale anteriore alta arrotondata, che, delabializzandosi, è passata sistematicamente a /i/, vocale anteriore alta non arrotondata: es. /si/ "occhio", /ʃtiɲ/ "spingo", /di/ "due";
- b) presenza del fonema consonantico /ç/, fricativa palatale sorda, in poche parole del fondo lessicale albanese come /çe/ "ombra", /çeθ/ "lancio", ma in molti prestiti di origine neogreca e bizantina, penetrati sia all'epoca del contatto linguistico greco-albanese (es. /ciro'mer/ "lardo", /ma'çere/ "coltellaccio", /raçi/ "poggio"), cioè prima del XV secolo, sia in una fase successiva all'insediamento in Italia, cioè dopo il XV secolo, attraverso il calabrese e gli altri dialetti romanzi del Mezzogiorno d'Italia (es. /'çeta/ "serto di fichi secchi legati a treccia", /'çersat/ "le terre incolte");
- c) sonorizzazione, in tutte le posizioni, della fricativa velare sorda: * /x/ > /ɣ/(ʔ): es. /'ɣəŋgra/ "mangiai", /'prəɣem/ "mi riposo", /ɲoɣ/ "conosco".

Ora, mentre i fenomeni (a) e (b) accomunano questa parlata alle altre parlate italo-albanesi, il passaggio della fricativa velare sorda alla corrispondente sonora (c) — seguendo lo schema di classificazione fonologica delle parlate arbëreshe proposto da Solano (1979b, p. 6) — rappresenta un tratto caratteristico di una isoglossa ristretta del Co-

sentino (Area IV), comprendente le parlate di Falconara, Marri, S. Sofia, S. Demetrio, Macchia, S. Cosmo, Vaccarizzo e S. Giorgio.

Sempre in riferimento alla succitata suddivisione per isoglosse fonologiche, la parlata di Macchia partecipa all'Area II, che comprende la maggior parte delle parlate albanesi della Calabria settentrionale, e che si caratterizza per l'esito /c/ e /t/ degli antichi nessi consonantici [kʎ] e [gʎ], e per l'evoluzione /pj/, /bj/, /fj/ e /vj/ dei nessi originari [pʎ], [bʎ], [fʎ] e [vʎ]: es. * /kʎaŋ/ > /caŋ/ "piango", * /gʎəmb/ > /təmb/ "spina", * /pʎak/ > /pjak/ "vecchio", * /bʎeŋ/ > /bjeŋ/ "compero", * /fʎeta/ > /fjeta/ "la foglia", * /vʎoŋ/ > /vjoŋ/ "conservo".

Altre caratteristiche in campo fonologico che contraddistinguono questa parlata, differenziandola dall'albanese comune e dalla maggior parte dei dialetti della madrepatria e della diaspora, sono: la pronuncia palatalizzata della laterale /ʎ/, che nell'albanese odierno è passata ad alveolare /l/: es. /'ʎumi/ "il fiume", /'ʎajta/ "lavai"; la conservazione di /ʎ/ — passata a /j/ nell'albanese comune — parzialmente in contesto intervocalico e sistematicamente nei nessi [ʎk] e [ʎg]: es. /bu'ʎar/ "nobile", /e-'biʎa/ "la figlia", /uʎk/ "lupo", /da'ʎgoŋ/ "capisco"; la riduzione in ogni posizione del nesso consonantico [ff] a [j]: es. /ʃiŋ/ "scopo", /'coʃa/ "possa io essere", /mu'ndaʃ/ "seta".

TABELLA DELLE VOCALI *

	anteriori — arrotondate	centrali — arrotondate	posteriori + arrotondate
alte	/i/		/u/
medio-alte			
medie	/e/	/ə/	/o/
medio-basse			
basse		/a/	

* Nel dialetto arbëresh di Macchia, le vocali toniche, in certe condizioni contestuali, presentano una realizzazione fonetica più allungata delle vocali atone, caratterizzandosi così come *varianti contestuali* — in termini strutturalistici — dei rispettivi fonemi vocalici. Inoltre, sempre in posizione tonica, sia le vocali anteriori che quelle posteriori, oltre che quantitativamente lunghe, sono un poco più aperte e rilassate che nell'albanese letterario. In tale posizione, perciò, i fonemi vocalici /i/, /u/, /e/, /o/ si realizzano rispettivamente nelle varietà allofoniche: [i:], [u:], [ɛ:], [ɔ:]. Nello stesso contesto anche il fonema /a/, oltre a presentare l'allungamento vocalico, viene pronunciato più aperto che in posizione atona.

DESCRIZIONE DEI FONEMI VOCALICI

- /i/ [i] : in posizione atona: vocale anteriore alta non arrotondata: [li'mun] "limone", [ɣiti] "entrarono";
 [i:] : in posizione tonica: vocale anteriore medio-alta non arrotondata: [i-'bɾi] "il figlio", [i'ktin] "fuggirono".
- /u/ [u] : in posizione atona: vocale posteriore alta arrotondata: [u'naza] "l'anello", [ɟur'be:ɟ] "io lavoro";
 [u:] : in posizione tonica: vocale posteriore medio-alta arrotondata: [druɾi] "il legno", [ɟurit] "la sabbia".
- /e/ [ɛ] : in posizione atona: vocale anteriore media non arrotondata: [me'nat] "domani", [be'koɟ] "benedisse";
 [ɛ:] : in posizione tonica: vocale anteriore medio-bassa non arrotondata: [vɛra] "l'estate, il vino", [fo'lea] "il nido".
- /o/ [ɔ] : in posizione atona: vocale posteriore media arrotondata: [o'reks] "voglia", [ko'pɾiɛ] "giovane formosa";
 [ɔ:] : in posizione tonica: vocale posteriore medio-bassa arrotondata: [ɣɔ'ɾca] "tirai", [bɔra] "la neve".
- /a/ [a] : in ogni posizione: vocale centrale bassa non arrotondata: [ar'brɛɟ] "albanese", [kalmer] "canna".

- /ə/ [ə] : in posizione tonica: vocale centrale media non arrotondata: [i-əmbɛʎ] "dolce", [ə:ft] "è", [ʔəmra] "il cuore";
- [ə] ~ [ø] : in posizione pretonica (*): [kə'saj] ~ ['ksaj] "di questa", [kə'mɪ:ʃ] ~ ['kmɪ:ʃ] "camicia";
- [e] ~ [ø] : in posizione postonica (*): ['əmer] "nome", ['dɔrø] "mano", ['vajzen] "la ragazza" (acc.), ['ciʃøs] "della chiesa".

LA LUNGHEZZA VOCALICA (*)

La quantità delle vocali — stando al materiale linguistico fornito dai parlanti giovani — non sembra avere in questa come in altre parlate albanesi, una funzione distintiva. Si tratta, invece, secondo l'accezione di Jakobson, di un tratto prosodico "pertinente" ma non "distintivo", dal momento che trasmette soltanto contenuti espressivi o emotivi nella comunicazione verbale.

L'allungamento vocalico si realizza di solito nel parlato "lento" e nel parlato "rapido" solamente nelle sillabe accentate delle parole che si trovano in fine di sintagma o di frase. All'interno del sintagma e della frase c'è invece la neutralizzazione di questa marca prosodica: es. /a'i ə:ft p-buR i-mir/ "egli è un uomo buono" ~ /sa mir-e-diʃ at-bu:R/ "quanto bene ha voluto a quell'uomo".

A determinare la lunghezza o meno di un fonema vocalico concorrono oltre all'accento, diversi altri fattori contestuali di natura fonetica. Essa è correlata, in gran parte, a condizioni fonetiche sincroniche, quali la posizione e la natura della sillaba e le particolarità articolatorie delle consonanti contigue, e — in alcuni casi — a condizioni fonetiche diacroniche, quali la conservazione della lunghezza vocalica originaria, l'allungamento di compenso conseguente alla caduta di schwa finale e la contrazione di più suoni o gruppi vocalici.

Le condizioni fonetiche sincroniche possono essere, almeno in parte, facilmente rappresentate per mezzo della seguente regola:

$$V \longrightarrow V: / \text{—————} ([+ \text{sonoro}]) \# \# \\ [+ \text{accento}]$$

con [+accento] che indica anche l'accento di frase.

L'allungamento vocalico va quindi considerato, in questa parlata albanese, un tipo di sistemazione o distribuzione fonetica di realizzazioni allungate delle vocali in dipendenza di certi caratteri, regolari, del contesto, che abbiamo schematizzato nella regola precedente con i tratti: [+ accento], [+ sonoro], confine di parola # #

Pur essendo estremamente problematica la individuazione di una regolarità in questo fenomeno fonetico, a causa dell'incrociarsi di condizionamenti fonetici sia sincronici che diacronici, è pure possibile, sulla base delle condizioni contestuali rappresentate nella regola suesposta, arrivare a definire alcuni ambiti di allungamento vocalico.

Si realizzano generalmente lunghe:

- le vocali accentate finali in sillaba aperta: [ðe:] "terra", [fo'ʎe:] "nido", [gra:] "donne", [ra:] "cadde" [pa:] "vide", [ʃpɪ:] "casa", [ʃɪ:] "pioggia";
- le vocali accentate in sillaba chiusa, seguite da sonanti liquide: [bɔ:r] "neve", [bɪ:r] "figlio", [mɪ:r] "bene", [ʃu:r] "ginocchio", [t-kɛ:r] "che abbia", [vɛ:r] "estate, vino", [ku'ʎa:r] "collare", [ka:ʎ] "cavallo", [pa:ʎ] "dote, palla", [ʃka:l] "scala", [za:l] "lido", [skɔ:l] "scuola", [fu:R] "forno";
- le vocali accentate in sillaba chiusa, seguite da ostruenti sonore: [ʃɪ:z] "ricotta", [mɪ:z] "mosca", [ʎu:g] "cucchio", [dɛ:g] "ramo"

Il cambiamento della struttura sillabica, provocato dall'aggiunta di suffissi flessionali e derivazionali — che non siano rappresentati ovviamente, nel contesto (a), da sonanti liquide e ostruenti sonore — neutralizza la quantità lunga delle vocali toniche: ['bɪrɪ] "il figlio", [pa'ʎa] "la dote, la palla", [ʃɪza] "la ricotta", ma [ra:r] "caduto", [pa:r] "visto".

Si realizzano, invece, generalmente brevi:

- le vocali atone: [in'zɔt] "Dio", ['trɪmi] "il giovane", [ku'fa:l] "tasca", [ʎɛpɪr] "lepre", [θɛrɛ'stɪ:] "giugno", ['nɪsɛ] "sposa", [vo'rɛa] "la tramontana";
- le vocali accentate in sillaba chiusa, seguite da ostruenti sorde: [mɛs] "vita, mezzo", [ʃɔk] "compagno", [buk] "pane", [Rɛθ] "cerchio";
- le vocali accentate in sillaba chiusa, seguite da nessi consonantici: [ʎɛʎ] "tiro", [ʃɪms] "metà", [ar'brɪʃt] "in albanese".

DITTONGHI E GRUPPI VOCALICI

In questa, come in altre parlate albanesi, ci imbattiamo in due distinte categorie di sequenze vocaliche: nei dittonghi propriamente detti e nei gruppi vocalici (*).

Nei dittonghi si ha in sostanza l'unione di una vocale con una semivocale — rappresentata da *i* o *u* — che può seguire o precedere. Se l'accento interno al dittongo è sul primo elemento vocalico, i dittonghi sono discendenti, mentre sono ascendenti quando l'accento interno al dittongo cade sul secondo elemento.

In questa parlata arbëreshe sono dittonghi discendenti:

- [aj] : /pstaj/ "poco fa", /maj/ "maggio", /'ajer/ "vento";
- [ej] : /vej/ 'andava", /a'tej/ "di là", /'trəmbej/ "si spaventava";
- [ij] : /pij/ "beveva", /frij/ "soffia", /ftij/ "spingi";
- [oj] : /moj/ "mese", /voj/ "conserva", /noj'tef/ "saggia";
- [uj] : /uj/ "acqua", /ruj/ "guarda", /'kuja/ "a chi";
- [əj] : /bəj/ "fa", /vəj/ "metti", /dzəj/ "apprendi".

Sono, invece, dittonghi discendenti:

- [ja] : /jap/ "do", /mia/ "miele", /pjaku/ "il vecchio";
- [je] : /i-'vjeγRi/ "il suocero", /vjeft/ "settembre", /pjejk/ "pesco";
- [jo] : /pjot/ "pieno", /mbjoŋ/ "riempio", /vjoŋ/ "conservo";
- [ju] : /'pjuγur/ "polvere", /'bjutur/ "macinato", /dju/ "non so";
- [ue] : /'kue/ "cavalli", /'γueR/ "guerra".

Le sequenze vocaliche [ua], [ie], [au], [eu], [iu], pur presentando l'accento sul primo elemento, vengono pronunciati come due sillabe distinte, e non sono perciò da considerare dittonghi, ma gruppi vocalici:

- [ua] : /'θua/ "unghia", /'grua/ "donna", /'mua/ "a me";
- [ie] : /'miel/ "farina", /u-'ndie/ "si senti";
- [au] : /'vlau/ "il fratello", /'fkau/ "scivolò", /'kau/ "il bue";
- [eu] : /'ðeu/ "la terra", /'preu/ "tagliò", /Rəm'beu/ "afferrò";
- [iu] : /'miu/ "il topo", /'fju/ "la pioggia", /'siu/ "l'occhio".

Pur avendo tutti questi gruppi vocalici la stessa struttura bisillabica, non rappresentano storicamente il risultato di una stessa evoluzione fonetica. Infatti, mentre [ua] e [ie] — che presentano come

secondo elemento le semivocali a ed e — scaturiscono dagli sviluppi di antichi dittonghi, a loro volta derivati dalle vocali toniche originarie */ō/ ed */ē/, [au], [eu], e [iu] rappresentano l'incontro di due unità morfematiche (vocale radicale + affisso flessionale). Passando tra le due vocali il confine di morfema / + /, esse vengono articolate e pronunciate distintamente in due unità sillabiche.

Da osservare inoltre che nei parlanti più giovani e più in generale in quelli meno legati a comportamenti linguistici conservativi, in sillaba chiusa e in sillaba aperta interna, si registra un processo fonetico di monottongazione che generalizza rispettivamente /u/ da [ua] e /i/ da [ie] e che possiamo interpretare con la seguente regola:

$$\begin{bmatrix} \text{ua} \\ \text{ie} \end{bmatrix} \longrightarrow \begin{bmatrix} \text{u} \\ \text{i} \end{bmatrix} / \text{ — [+ segmento] }$$

Non si ha invece la riduzione sistematica di questi gruppi vocalici al primo elemento, in sillaba libera finale, cioè davanti a confine di parola:

es. /'grua/ "donna", /u-γa'Rua/ "si dimenticò", /'krie/ "testa", /u-'ndie/ "si senti".
"cuoci".

TABELLA DELLE CONSONANTI

		bilabiali	labioden- tali	apicoden- tali	dentali	palatoal- veolari	alveolari	palatali	velari	
I S U O R I S O N I	occlusive	sonde	/p/		/t/			/c/	/k/	
		sonore	/b/		/d/			/tʃ/	/g/	
	affricate	sonde				/ts/	/tʃ/			
		sonore				/dz/	/dʒ/			
	fricative	sonde		/f/	/θ/	/s/	/ʃ/		/ç/	
		sonore		/v/	/ð/	/z/	/ʒ/		/ʝ/	/ɣ/
I S U O R I S O N I	nasali		/m/		/n/			/ɲ/		
	liquide	laterali					/l/	/ʎ/		
		monovibranti				/r/				
polivibranti					/R/					

DESCRIZIONE DEI FONEMI CONSONANTICI

consonanti occlusive

